

Njoftim për media

Censi i Popullsisë dhe Banesave

Risitë që do të sjellë numërimi i popullsisë në 2020

Tiranë, më 16 Maj 2018: Censi i vitit 2020 si shtylla kryesore e sistemit kombëtar të statistikave dhe sfidat e tij kanë qenë temat kryesore të diskutimit në takimin e parë përgatitor të organizuar nga INSTAT në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Europian në Shqipëri. Duke qenë se ky është procesi më i rëndësishëm demografik i një vendi, kërkon një përdorim të madh burimesh financiare dhe njerëzore. Censi 2020 do të ketë një kosto rreth 16.2 milion lekë.

Nga pikëpamja e efektivitetit të koston, qëllimi i këtij Censi është të planifikohet dhe të kryhet në një mënyrë sa më pak të kushtueshme, pa kompromentuar objektivat e tjerë strategjikë. Objektivat e Censit 2020 kanë të bëjnë me minimizimin e koston duke adoptuar qasje dhe teknologji sa më eficiente lidhur me grumbullimin, kapjen dhe procesimin e të dhënave.

Në fjalën e saj, Drejtoresha e Përgjithshme e INSTAT, Znj. Delina Ibrahimaj, u shpreh se Zhvillimi ekonomik dhe social i një vendi duhet të mbështetet në vendimmarrje të bazuar në të dhëna të sakta, ndaj dhe prodhimi në kohë dhe me saktësi i statistikave është thelbësor. “Roli thelbësor i Censit të popullsisë dhe banesave është të mbledhë, përpunojë dhe të shpërndajë të dhënat e detajuara për këto njësi të vogla në lidhje me popullsinë, përbërjen e saj, karakteristikat, shpërhapjen hapësinore dhe organizimin e njësive ekonomike familjare. Roli kryesor i një censi është të prodhojë një numërim të saktë të popullsisë rezidente të një vendi. Ndërsa në terma të administrimit publik, ky numërim është i nevojshëm dhe përdoret në shumë vende për ndarjen e barabartë të fondeve publike apo dhe për organizimin e proceseve zgjedhore”, tha Znj. Ibrahimaj.

I pranishëm në këtë takim, Z. Mario Mariani, Drejtues i Zyrës së Bashkëpunimit pranë Delegacionit të BE në Tiranë, tha se për të lehtësuar dhe shpejtuar procesin e regjistrimit të popullsisë është shumë e rëndësishme të merren masa në përgatitjen e regjistrave dixhitale në sistemin e njësive vendore të qeverisjes. Sipas tij, ky është hapi i parë dhe i duhuri drejt arritjes së qëllimit.

Për këtë arsye, INSTAT do të nisë zbatimin e projektit “Mbështetje për Statistika të Forta Vendore Shqiptare” (SALSTAT), i cili ka për qëllim të ndërtojë dhe mbajë një regjistër statistikor në nivel lokal (nga Bashkitë) dhe në nivel kombëtar (nga INSTAT).

Përmes këtij projekti do të jetë e mundur të përmirësohet administrimi bashkiak duke siguruar efikasitet, efektivitet dhe pjesëmarrje të qytetarëve të tyre, bazuar në përmirësimin e mbledhjes dhe analizimit të dhënave sipas standardeve të Eurostat-it. SALSAT është tërësisht i financuar nga Zyra e Bashkëpunimit Zvicerian për Zhvillim (SDC) dhe Zyra Statistikore Federale Zviceriane.